



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.221/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Afijete Sada - Gllogjani anëtare, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partija Kosovskih Serba (PKS), paraqitur kundër subjektit politik Lista Serbe, për shkak të thyerjes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e Tyre dhe Kandidatët, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 17.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Partija Kosovskih Serba (PKS), me nr. ZL.Anr.221/2017 e paraqitur me datë 17.10.2017, me të cilën kërkohet që subjektit politik Lista Serbe, ti shqiptohet dënimi me gjobë, për shkak të thyerjes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e Tyre dhe Kandidatët.

A r s y e t i m

Subjektit politik Partija Kosovskih Serba (PKS), ka parashtruar ankesë në PZAP me datë 17.10.2017, me të cilën pretendon se subjekti politik Lista Serbe gjatë fushatës zgjedhore në ka shkelur nenin 4 të Rregullës Zgjedhore nr.11/2017 duke bërë heqjen, mbulimin dhe dëmtimin e posterave të subjektit politik PKS si dhe mbulimi i posterave dhe billbordeve të kryetarit të Komunës së Laposaviqit.

Më tej në ankesë parashtruesi i ankesës thekson se subjekti politik Lista Serbe kanë bërë shkeljen e nenin 5.2 të Rregullës Zgjedhore 13/2013, për arsye se ka bërë fushat me fëmijë nën moshën 18 vjet dhe fotot e tyre i ka postuar në rrjetin social facebook.

Parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur fotografi.

Në përgjigjen në ankesë subjekti politik Lista Serbe, të datës 17.10.2017, theksojnë se ankesa e paraqitur nga subjekti politik PKS është e parregullt dhe nuk i plotëson të gjitha kushtet

Ligjore në mënyrë që ankesa të pranohet. Lidhur me posterat e dëmtuar në përgjigje në ankesëe Lista Serbe i mohon të gjitha akuzat lidhur dëmtimin e qëllimshëm të posterave të PKS-së, ndërsa e mohon faktin e përfshirjes së fëmijëve në fushatë pasi që fotot e ekspozuara në përmes rrjetit social facebook, ku shihen fëmijët nuk është faqja zyrtare e Listës Serbe.

I njëjti kërkon nga PZAP-i që ankesa e bërë ndaj tyre të hudhet poshtë si e palejuar për shkak se është parashtruar nga personi i paautorizuar.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore se Lista Serbe gjatë fushatës zgjedhore në Komunën e Leposaviqit ka bërë heqjen, mbulimin dhe dëmtimin e posterave të subjektit politik PKS si dhe mbulimin e posterave dhe billbordeve të kryetarit të Komunës së Leposaviqit, paneli në bazë të provave të ofruara nga parashtruesi i ankesës nuk ka mundur që të vërtetoj se këto shkelje të pretenduara i ka bërë Lista Serbe. Paneli po ashtu vlerësoj se janë të paqëndrueshme pretendimet në ankesë se subjekti në fjalë ka përfshirë persona nën moshën 18 vjeçare në fushatë, për arsye se nga fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës nuk kanë asnjë element të fushatës zgjedhore kurse nga postimi i bërë në foto vërehet qartë se fëmijët kanë qenë në shoqërim të prindit dhe nuk shihet se ata kanë qenë duke promovuar ndonjë material zgjedhorë të subjektit në fjalë.

Me këtë rast paneli konsideron, se parashtruesi i ankesës, me dëshmitë e ofruara nuk i ka vërtetuar pretendimet e tij në mënyrë që paneli të merr vendim në favor të tij.

Nga arsyet e theksuara më dhe duke u bazuar në nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZL.Anr. 221/2017 me datë 17.10.2017.



Kryesuesi i Panelit
Adnan Konushevc

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par.4 të LZP-së.